

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
	Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 1/3

PSB, 24.11.2021

Titulli i DPS/KT:

DPS/KT 136 “Sporte dhe sheshe lojërash”

A Historiku

DPS/KT 136 është krijuar në 28.02.2004, në përputhje me Ligjin Nr. 9870 “Për Standardizimin”, i ndryshuar dhe rregulloret e brendshme të DPS në përputhje me rregulloret/udhëzuesit dhe strategjitë e CEN/CENELEC dhe ISO/IEC, mbi krijimin dhe funksionimin e Komiteteve Teknike.

Fusha e këtij KT është adoptimi i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare CEN/ISO për standardizimin e sipërfaqeve për ambiente të brendshme dhe të jashtme sportive, kërkesat e sigurisë dhe të performancës, metodat e testimit të pajisjeve dhe shesheve sportive, si dhe shesheve të lojrave.

B Mjedisi i biznesit

B.1 Të përgjithshme

Puna e DPS/KT 136 vazhdon me një ritëm të shpejtë për shkak të fokusimit të këtij KT në çështjet e mjedisit dhe toksikologjisë. Për më tepër DPS/KT 136 merr parasysh dhe konsideratat mjedisore për sa i përket standardeve për projektimin e sipërfaqeve sportive në mjediset e jashtme dhe të brendshme. Standardet e adoptuara nga ky KT janë të rëndësishme pasi sigurojnë një projektim cilësor dhe të sigurt të shesheve të lojrave dhe pajisjeve në sipërfaqet sportive.

B.2 Treguesit sasiore të mjedisit të biznesit

Përdoruesit e standardeve të adoptuara nga DPS/KT 136 përfshijnë prodhuesit, personat që instalojnë pajisjet në sipërfaqet dhe sheshet sportive dhe sheshet e lojrave, organizmat certifikues, autoritetet lokale, laboratorët e testimit të provës, institucionet kërkimore, si dhe dhe autoritete të federatave sportive (organet drejtuese).


Standardet e adoptuara nga ky KT kanë përdorim të gjerë dhe synojnë:

- përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së pajisjeve dhe projektimit të shesheve sportive;
- kontrollin e prodhimit dhe projektimit;
- sigurinë e cilësisë;
- përmirësimin e konkurrencës;

C Përfitimet

Puna e DPS/KT 136 duhet të rezultojë në adoptimin e standardeve që do të mundësojnë:

- shfaqjen e përparimeve teknike në sipërfaqet dhe sheshet sportive;
- rritjen e cilësisë së sipërfaqeve sportive dhe sigurinë e të gjithë përdoruesve në këto sheshe;
- këshillimin për prodhuesit, importuesit dhe shpërndarësit;

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
	Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 2/3

- krijimin e një mjedisi konkurrence të ndershme midis prodhuesve në mbarë botën;
- mbështetjen për legjislacionin evropian;
- minimizimin e interpretimeve të ndryshme në rast të mbikëqyrjes së tregut nga publiku;

D Pjesëmarrja në DPS/KT 136

Në DPS/KT 136 ka përfaqësues nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Instituti i Ndërtimit, si dhe nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit (Bashkia Tiranë) i cila administron Sheshet & Parqet Rekreative, Veprën REJA, Parqet Memoriale, Zoo Park, Amfiteatrin, Parkun Olimpik, Bimësinë e Pyllit Orbital, Kurorën e Gjelbër, Pyjet & Kullotat, dhe Aktivitetet në Natyrë në Bashkinë e Tiranës. Palët e interesuara në raste të veçanta për probleme specifike mund të emërojnë ekspertët e tyre në grupet e punës të ngritura nga KT për çështje specifike.

E Objektivat dhe strategjitë

E.1 Objektivat e përcaktuara nga DPS/KT 136

- Miratimi i standardeve, në përputhje me procedurat për hartimin dhe adoptimin e standardeve shqiptare dhe dokumentet e tjera të standardizimit, për sigurinë dhe cilësinë e pajisjeve të shesheve sportive dhe shesheve të lojërave, specifikimet teknike të pajisjeve për terrenet sportive të cilat janë të veshura me bar artificial, si metodat e testimit të cilat mbulohen nga ky KT, duke përgatitur çdo vit programin e punës së KT;
- Adoptimin e standardeve të harmonizuara nën direktivën (Rregulloren 2016 425”Pajisje Mbrojtëse Personale” në masën 100 %, duke bërë ndryshimet në listën e standardeve nën këtë Rregullore sa herë që ato përditësohen;
- Përfaqësimi i interesave kombëtare në organizmat evropiane dhe ndërkombëtare kur ajo kërkohet;
- Aplikimi i parimeve themelore të standardizimit;
- Përgatitja dhe pasurimi me terma të reja të fushës i fjalorit terminologjik;

E.2 Strategjitë e përcaktuara për arritjen e objektivave

Përmbushja e objektivave të DPS/KT 136 bazohet në punën për adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare, duke bashkëpunuar me KT "pasqyrë" të CEN dhe ISO si më poshtë:

CEN/TC 136	Sheshe sportive dhe sheshe lojërash, dhe pajisje të tjera rekreative
CEN/TC 217	Sipërfaqe për sheshet sportive
CEN/TC 245	Automjetet e akomodimit në kohë të lirë
CEN/TC 315	Lehtësira për spektatorët
CEN/TC 333	Biçikleta
CEN/TC 346	Ruajtja e Trashëgimisë kulturore
ISO/TC 83	Pajisjet sportive dhe objektet e tjera rekreative

F Planifikimi

Për realizimin e objektivave të mësipërme ky KT bazuar në propozimin e standardeve të reja fillon punën për adoptimin e standardeve.

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 3/3	

G Financimi

Kryetari dhe anëtarët punojnë mbi baza vullnetare dhe pa pagesë.

Sekretari i DPS/KT 136

(Elona TELULI)